



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 499, datë 21.10.2020

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...}
DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË
GJYKATËN E APELIT TIRANË, PËR POZICIONIN E LIRË NË
FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN
NR. 179, DATË 28.05.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 21.10.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës, të kandidates për në Gjykatën e Apelit Tiranë, znj. {...}”, përgatitur nga relatori z.Illir Toska, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin Këshillit nr. 179, datë 28.05.2020,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 179, datë 28.05.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

...

3. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

...”.

2. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë pozicion të lirë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 29.05.2020, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 15.06.2020.

3. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

4. Me Vendimin nr. 238, datë 07.07.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”, Këshilli ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.173, nr.174, nr.176, nr.179, nr.180, nr.181, nr.182, nr.183, nr.184, nr.185, nr.186, nr.187 dhe nr.188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ... 15. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Ilir Toska;...”

5. Po në këtë Vendim, në pikën 3 të tij, ndër të tjera, Këshilli ka vendosur që për kandidaten znj. {...}, e cila ka kandiduar edhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që është në proces e sipër në kuadër të këtij kandidimi, është e vlefshme edhe për kandidimin e saj për pozicionin e lirë në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, pikërisht për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, të shpallur me Vendimin e tij nr.179, datë 28.05.2020.

6. Më datë 07.07.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

7. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Referuar disponimit të pikës 3, të Vendimit të Këshillit nr. 238, datë 07.07.2020, meqënëse procedura e verifikimit të kritereve të pasurisë dhe figurës për këtë kandidate ishte në proces përpara Këshillit në kuadër të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që kjo procedurë është përcaktuar nga Këshilli si e vlefshme edhe për procedurën e ngritjes në detyrë të kandidates në Gjykatën e Apelit Tiranë, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, më datë 16.07.2020, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan vetëm dy nga deklaratat dhe autorizimet sipas pikës 6, të këtij seksioni dhe kreu, të Vendimit 75/2019, konkretisht Autorizimi “Për verifikimin e kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit për

gjyqtar në gjykatat e apelit”, si dhe Deklarata “Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale”.

9. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ç’ka nënkuptoi të drejtën e Këshillit për të vijuar verifikimin me kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

10. Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr.179, datë 28.05.2020, është përcaktuar se: *“Për kandidatën, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç” të pikës 5 të këtij vendimi, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional:...”*. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimin të tre kriterëve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, që janë kriteri i *“përvojës profesionale minimale”*, i *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”* dhe i *“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”*, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten znj. {...} u kërkuar dhe u administruar informacioni i nevojshëm nga institucionet kompetente.

11. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidaten znj. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të përmendur më lart, Këshilli me Vendimin nr.283, datë 08.09.2020, ka vendosur:

“1. Verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 179, datë 28.05.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 179, datë 28.05.2020”.

12. Ndërkohë, në lidhje me verifikimin e kriterëve të pasurisë dhe të figurës, sikurse u sipërcitua, duke qenë se kandidatja kishte kandiduar më parë për ngritjen në detyrë edhe pranë Gjykatës së Lartë, për dy pozicione të lira, të shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020, në pikën 3 të Vendimit nr. 238, datë 07.07.2020 u përcaktua se procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që është në proces e sipër për këto kandidime, është e vlefshme edhe për kandidimin e saj për pozicionin e lirë në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallur me Vendimin nr. 179, datë 28.05.2020.

13. Rezulton se procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës për kandidaten znj. {...}, për kandidimet e saj për ngritjen në detyrë pranë Gjykatës së Lartë, ka përfunduar dhe Këshilli, me Vendimin nr. 371, datë 28.09.2020, ka vendosur:

“1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020...””.

14. Në kushtet kur kandidatja është verifikuar për plotësimin e kriterëve të pasurisë dhe figurës në kuadër të kandidimeve të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, përfundimet e arritura në Vendimin nr. 371, datë 28.09.2020 janë të vlefshme edhe në kuadër të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 179, datë 28.05.2020.

15. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit në lidhje me kriteret e pasurisë dhe atë të figurës për kandidaten {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 09.10.2020, relatori e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

16. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 12.10.2020 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin ose jo të kandidates {...} dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.179, datë 28.05.2020.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE TË FIGURËS

17. Verifikimi me sukses i pasurisë dhe figurës janë kriteret për çdo kandidim ngritjeje në detyrë, përfshirë edhe për në gjykatat e apelit. Për rrjedhojë, sikurse dhe më lart u përmend, ndërsa znj. Veizi ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve dhe, më pas, edhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, procedura këto që po vijnë në të njëjtën kohë, rezultatet e verifikimit të këtyre kriterëve në kuadër të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, janë të vlefshme edhe sa i përket kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

A. Për kriterin e pasurisë

18. Lidhur me verifikimin e pasurisë së kandidates, në kuadër të kandidimeve të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, në Vendimin nr. 371, datë 28.09.2020, Këshilli ka konkluduar se:

“23. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;*
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;*
- c) kandidatja ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e saj;*
- ç) deklarimi nga kandidatja i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t’u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë”.*

19. Ndaj sa sipër, duke qenë se rezultatet e verifikimit të pasurisë sipas pikës 18 të këtij vendimi, janë të vlefshme edhe sa i përket kandidimit të znj. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, Këshilli vlerëson se në këtë rast janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për kandidaten nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimit për ngritjen e saj në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

B. Për kriterin e figurës

20. Lidhur me verifikimin e figurës së kandidates, në kuadër të kandidimeve të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, në Vendimin nr. 371, datë 28.09.2020, Këshilli ka konkluduar se:

“30. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;*
- b) kandidatja ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit të Statusit, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;*
- c) për kandidaten nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;*
- ç) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit, përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;*

- d) për kandidaten nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjente e shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidaten nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e saj, mbi të cilat mund të gjykohet për pranueshmërinë ose jo të saj për emërimin si gjyqtare në Gjykatën e Lartë”.

21. Ndaj sa sipër, duke qenë se rezultatet e verifikimit të figurës sipas pikës 20 të këtij vendimi, janë të vlefshme edhe sa i përket kandidimit të znj. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, Këshilli vlerëson se në këtë rast janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për kandidaten nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimit për ngritjen e saj në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

III. KONKLUZIONE

22. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

23. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 179, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 4, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 179, datë 28.05.2020.
2. Vendimi nr. 283, datë 08.09.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR